

VIVANDO

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS 09

Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit

Një fungicid sistemik në formë suspensioni të koncentruar, vepron tek hiret në kungullore dhe vresht, duke penguar rritjen e micelit në sipërfaqe të gjethes, depërtimin dhe formimin e haustoreve si dhe sporifikimin. Mekanizmi veprimit: **Kodi FRAC B6:** Actin/myosin/fimbrin.

Formulimi: *Koncentrat i suspendueshëm (SC)*

Përmbajtja: *Metrafenone 500 gr/lit.*

Masat parambrojtëse:

Deklarat e rrezikut:

H411: Toksik për jetën ujore duke shkaktuar efekte afatgjata të dëmshme.

EUH208: Mund të prodhojë reaksion alergjik, Përmban 1,2-benzisothiazol-3(2H)-one.

EUH401: Të evitohen rreziqet e shëndetit të njeriut dhe ambjentit, në përpuethshmëri me instruksionet për përdorim.

Deklarata paraprake:

P102: Mbajeni në vende të sigurta, larg fëmijëve.

P103: Lexoni etiketën para përdorimit.

Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për kafshët. Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës dhe marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë punës. Gjatë punës mos hani e pini lengje dhe duhan, përdor paisje mbrojtëse. Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet spërkatëse, duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

Në rast kontakti me lëkurën ose mukozat, lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun. Në rast thithje të tretësirës spërkatëse me organet e frymëmarrjes, i aksidentuari çohet në një mjedis të ngrohtë dhe të ajrosur. Në rast helmimi, kërkoni menjëherë ndihmë në qendrën me të afërt spitalore, duke i treguar mjekut etiketën e këtij produkti. Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi sipas simptomave

Deklarata paraprake:

P391: Mblidhni dhe pastroni rrjedhjet.

Deklarata paraprake (Ruajtja):

P501: Asgjësoni ose largoni përmbajtjen/ambalazhin në përputhje me rregullat në fuqi.

Përdorimi:

Vivando përdoret në të lashta, perime (kungullore, solanore, bishtajore, etj.), pemë frutore dhe vresht, për kontrollin e hireve.

Rrush për tavolinë dhe verë: Hirin (*Uncinula necator*) aplikohet 20 ml/100 lit ujë (200-600 ml/Ha). Si trajtime parandaluese. Trajtimet duhet të fillojnë kur lastari ka arritur 10 cm gjatësi, deri në 3 trajtime në sezon me interval kohor 7-10 ditë.

Kungullore: Për kontrollin e hirit (*Erysiphe spp.*, *Sphaerotheca spp.*) 150-300 ml/ha. Nëse vëllimi i ujit tejkalon 500 lit/ha, aplikohet në normën prej 15 ml prod/100 ml ujë për të bërë një mbulim të plotë të bimës me solucion. Deri në 3 trajtime në sezon me interval kohor 7-10 ditë.

Vërejtje për përdorimin:

Në fillim përzihet preparati me pak ujë dhe kur të jetë homogjenizuar mirë shtohet sasia tjetër e ujit. Nuk përzihet me produkte alkaline.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat e mësipërme dhe sipas dozave të rekomanduara.

Ndikimi në ekosistem:

Mesatarisht helmues për bletët. Mesatarisht helmues për jo vertebrorët ujorë. Mos ndotni ujërat dhe basenet ujore me produktin ose ambalazhin e tij.

Koha e pritshmërisë (karenca):

Rrush 28 ditë; Kungullore 3 ditë.

Magazinimi:

Ruajeni në ambalazhin origjinal, në vende të thata e të ajrosura, të shmangura nga rrezet direkte të diellit dhe në temperatura nën 38⁰ C.

Numri dhe data e regjistrimit: Nr. 359; datë 29.12.2010;

Sasia neto e PMB-së, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1000 ml.

Bar kodi përkatës:

Data e prodhimit:Printuar nga makineria në ambalazh.....;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 5 vjet;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: Printuar në ambalazh.....;

Tipi i ambalazhit bazë: shishe COEX ose HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e Aplikantit: BASF SE. **Adresa:** Ludwigshafen, Gjermani.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-së: BASF SE. **Adresa:** Ludwigshafen, Gjermani.

Distributori për Shqipërinë: AgroHelp-SA. sh.p.k. Adresa: Autostrada Tir-Durr, km 22, Xhafzotaj, Durrës.